

## **Hapet thirrja për aplikim për 1 (një) bursë në kuadër të Programit Erasmus+ për staf akademik me kohë të plotë për mësimdhënie pranë Universitetit Palacky, Olomouc-Çeki**

Në kuadër të programit Erasmus + hapet thirrja për aplikim për 1 (një) bursë për mobilitete për stafin akademik me kohë të plotë të UST për mësimdhënie gjatë Javës Ndërkombëtare të Mësimdhënies pranë Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin Palacky Olomouc-Çeki <https://ftk.upol.cz/en/international/itë/>

### **Mobiliteti përfshin:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie nga të gjitha njësitë e UST-së.

### **Kohëzgjatja e mobilitetit:**

- 5 ditë + 2 ditë udhëtim

### **Bursa përfshin:**

- Kompensimin ditor
- Koston e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).  
Për të përcaktuar distancën, klikoni në linkun e mëposhtëm:  
[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Bashkëlidhur do të gjeni në gjuhën angleze dhe informacionin e plotë për këtë javë ndërkombëtare.

### **Dokumentet që duhet të dorëzohen:**

1. *Curriculum Vitae në gjuhën Angleze në formatin Europass;*
2. *Fotokopje e pasaportës;*
3. *Letër motivimi në gjuhën Angleze;*
4. *Certifikata që vërteton njohuritë e gjuhës Angleze.*
5. *Plani i Mobilitetit.*

### **Plani i mobilitetit**

Për të shkarkuar formatin e planit të mobilitetit klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://ust.edu.al/erasmus-2/>

Plani i mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit.

Ky dokument firmoset vetem nga aplikanti në momentin e aplikimit.

**Afati i fundit për aplikim: 10/03/2026**

Dokumentet duhen dorëzuar në Zyrën e Protokollit në Rektoratin e Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe të skanuara në adresë: [erasmus@ust.edu.al](mailto:erasmus@ust.edu.al)

Dokumentacioni i dorëzuar në zyrën e protokollit, duhet të shoqërohet me formularin e aplikimit që përmban të dhënat për çdo aplikant dhe duhet të firmoset nga ky i fundit.

Për të shkarkuar formularin klikoni në linkun e mëposhtë:

<https://ust.edu.al/erasmus-2/>